

Përmbledhje

- **Ekonomia e eurozonës** shënoi rritje reale prej 0.3 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2023, sipas Eurostat, rritje e ngadalësuar që kryesisht u ndikua nga shkalla e lartë e inflacionit, rënia e aktivitetit industrial dhe shtrëngimi i politikave monetare. Shkalla e inflacionit në TM2 2023 ka vazhduar trendin e rritjes duke arritur në 6.2 përqind, duke shtyrë BQE-në të rrisë normën bazë të interesit për herë të pestë brenda vitit 2023. Shkalla e inflacionit për vitin 2022 ishte 8.4 përqind, ndërsa projeksionet e BQE-së sugjerojnë një ngadalësim të inflacionit në 5.4 përqind në 2023 dhe 3.0 përqind në vitin 2024.
- **Aktiviteti ekonomik në TM2 2023 është ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.** Vlerësimet e ASK-së sugjerojnë se Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej vetëm 2.0 përqind në TM2 2023, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të eksporteve neto. Rritja e deficitit të tregtar ishte kryesisht rezultat rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve, ndërkohë që eksporti i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje të ngadalësuar. Në anën tjetër, konsumi ka shënuar rritje më të lartë, si rezultat i rritjes së burimeve të financimit si dhe ngadalësimit të rritjes së çmimeve të konsumit. Po ashtu, investimet vlerësohet se kanë shënuar një rritje më të lartë krahasuar me tremujorët paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve publike si dhe kredive të reja investuese. Për gjysmën e dytë të vitit 2023, aktiviteti ekonomik pritet të mbështetet nga investimet e përgjithshme, konsumi publik dhe eksporti i shërbimeve, ndërkohë që ndikim negativ pritet të ketë eksporti i mallrave.
- **Buxheti i Kosovës në TM2 2023 shënoi bilanc primar buxhetor pozitiv**, si rezultat i rritjes së të hyrave buxhetore, ndërsa borxhi publik ra në 17.3 përqind të BPV-së, krahasuar me 20.8 përqind në TM2 2022. Përmirësimi i bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritja e BPV-së nominale, që zvogëlon raportin e borxhit ndaj BPV-së, kanë qenë faktorët kryesor që kanë ndikuar në rënien e nivelit të borxhit publik.
- **Presionet inflacioniste** vazhduan të zbuten në TM2 2023 me normën e inflacionit të përgjithshëm që shënoi ngadalësim si rezultat i efektit të bazës, lehtësimeve në zinxhirët e furnizimit dhe çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Rritje e ngadalësuar u evidentua në pjesën më të madhe të komponentëve në shportën e konsumit, ndërsa çmimet e energjisë shënuan rënie. Ngjashëm, edhe inflacioni bazë shfaq shenja të ngadalësimit në TM2 2023.
- **Llogaria rrjedhëse** ka shënuar bilanc negativ prej 328.0 milionë euro në TM2 2023, dinamikë që kryesisht është përcaktuar nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave. Bilanci i mallrave shënoi deficit tregtar, ndikuar kryesisht nga vlera e lartë e importit të mallrave. Në anën tjetër, bilanci i shërbimeve, të hyrat parësore dhe të hyrat dytësore ndikuan në tkurrjen e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, një ndër burimet më të rëndësishme financuese të konsumit, remitencat, shënuan rritje prej 15.8 përqind, duke arritur në 363.8 milionë euro.
- Përkundër sfidave nga rreziqet më të larta me të cilat u përballë ekonomia, si inflacioni i rritur dhe perspektiva më e dobët ekonomike, **sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm të përshpejtuar**. Sektori bankar dhe sistemi financiar në përgjithësi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të jashtme si rezultat i tensioneve gjeo-politike në Evropën Lindore, kurse inflacioni mbetet rreziku kryesor.
 - **Sektori bankar** ndër vite ka arritur të siguroj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo-performuese. Gjendja e kënaqshme e këtyre indikatorëve i jep përparësi sektorit në absorbimin e goditjeve nga pasiguritë e shkaktuara nga krizat gjeopolitike, rritja e inflacionit dhe ngadalësimi ekonomik. Në TM2 2023, aktiviteti kreditues ishte kontribuuesi kryesor në rritjen e aseteve të sistemit financiar, pasuar nga investimet në letrat me vlerë dhe parasë së mbajtur në bankat tjera (kryesisht si depozitë në bankat jashtë vendit). Shtrëngimi i politikave monetare që nga viti i kaluar është reflektuar në rritje të normave të interesit në kredi dhe depozita edhe në tregun vendor. Rritja e normave të interesit në depozita ka nxitur rritjen e mjeteve të depozituara, me ç'rast norma e rritjes ishte në nivel rekord në 14 vitet e fundit, për të gjitha segmentët (depozitat e ekonomive familjare, korporatave jofinanciare, korporatave publike dhe korporatave tjera financiare).
 - **Sektori pensional** shënoi rikuperim të ritimit të rritjes, duke arritur nivelin e para pandemisë, pas ngadalësimit të theksuar (veçanërisht në vitin paraprak), si rrjedhojë e luhatjeve të mëdha në tregjet financiare ndërkombëtare pas përkeqësimit të situatës gjeo-politike në Evropën Lindore. Kurse, në vitin 2023, deri në qershor sektori pensional shënoi kthimi pozitiv në investime dhe rritje të kontributeve të arkëtuara. Pas turbulencave në tregjet financiare në tremujorin e parë të vitit, në periudhën prill-qershor 2023 tregjet financiare kishin performancë më të mirë, e cila u reflektua edhe në kthimin bruto në investime të fondeve pensionale të Kosovës.
 - **Sektori i sigurimeve** u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit krahasuar me periudhën paraprake, ndikuar nga niveli i lartë i primeve të arkëtuara. Dëmet e paguara gjatë kësaj periudhe ishin më të larta se një vit më parë, por rritja më e theksuar e primeve të arkëtuara ka ndikuar që sektori të përmirësoj tutje pozitën financiare krahasuar me vitin e kaluar.
 - Me rritje të përshpejtuar të aseteve u karakterizua **sektori mikrofinanciar**, atribuar kryesisht rritjes së aktivitetit kreditor dhe në masë më të ulët lizingjeve, që u financuan kryesisht nga huazimet prej sektorit të jashtëm (linjave kreditore) dhe kapitalit aksionar. Indikatorët e shëndetit financiar gjithashtu tregojnë për stabilitet të sektorit në përgjithësi, ndërkohë që rezultati financiar pothuajse ruajti nivelin e vitit të kaluar.

Përmbajtja

Përmbledhje	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	2
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	2
Rritja Ekonomike	4
Çmimet	5
Sektori Fiskal	8
Sistemi financiar	12
1. Sektori bankar	12
Kreditimi	13
1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake	15
1.2 Normat e interesit	16
Sektori pensional	19
Sektori i sigurimeve	21
Sektori mikrofinanciar	22
Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës	25

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e eurozonës shënoi rritje reale prej 0.3 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2023, sipas Eurostat. Rritja e ngadalësuar u ndikua nga shkalla ende e lartë e inflacionit, rënia e aktivitetit industrial dhe shtrëngimi i politikave monetare nga BQE. Ekonomia e eurozonës është ndikuar ndjeshëm nga rritja e çmimeve të konsumit dhe kostos së financimit. Shtrëngimi i politikës monetare nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), më i shpejti në mbi dy dekada, ka ndikuar në rënien e besueshmërisë së konsumatorëve dhe dobësimin e sentimentit të investimeve. Projektionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE janë rishikuar në qershor kundrejt projeksioneve të marsit, në 0.9 përqind për vitin 2023 dhe 1.5 përqind për vitin 2024.

Shkalla e inflacionit në TM2 2023 ka arritur në 6.2 përqind (8.0 përqind në TM2 2022), e ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit. Në gusht 2023, për herë të pestë brenda vitit, BQE-ja filloi me rritjen e tri normave kyçe të interesit: normën e depozitave (3.75 përqind në gusht 2023), normën e operacioneve të rifinancimit (4.25 përqind) dhe normën marginale për huadhënie (4.50 përqind). Projektionet e BQE-së sugjerojnë një ngadalësim të inflacionit në 5.4 përqind në 2023, dhe 3.0 përqind në vitin 2024.

Në mungesë të të dhënave për TM2 2023 nga agjencitë e statistikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor, projektionet e FMN-së sugjerojnë se rajoni pritet të shënojë një rritje mesatare ekonomike prej 2.1 përqind në vitin 2023 dhe 3.2 përqind në 2024. Rritja e ngadalësuar në vendet e Ballkanit Perëndimor është vlerësuar se do të ndikohen si nga presionet e jashtme (ngadalësimi i rritjes ekonomike në eurozonë dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare), ashtu edhe nga efektet e brendshme si përballja me inflacion dhe rritja e kostos së financimit. Çmimet ende të larta të energjisë dhe ushqimeve rritën presionet inflacioniste në të gjitha vendet e rajonit, duke ulur fuqinë blerëse, shpenzimet e konsumatorëve dhe duke ngadalësuar kërkesën e përgjithshme. **Shkalla mesatare e inflacionit në TM2 2023 në vendet e rajonit rezulton të ketë qenë 8.2 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Serbi prej 14.5 përqind dhe në Maqedoninë e Veriut prej 11.2 përqind, ndërsa Kosova rezulton të ketë shënuar normën më të ulët të inflacionit prej 4.2 përqind.** Në përpjekje për të luftuar inflacionin në rritje, Bankat Qendrore në vendet e rajonit (vendet të cilat kanë monedhat e tyre vendore) kanë vazhduar të rrisin normën bazë të interesit edhe gjatë vitit 2023.

Në TM2 2023, tregu i këmbimit valutor i euros kundrejt valutave të partnerëve tregtar u vlerësua për ndaj dollarit amerikan dhe lirës turke. Vlera e valutës euro mbeti pothuajse e njëjtë ndaj dinarit serb dhe denarit maqedonas, ndërsa u zhvlerësua kundrejt lekut shqiptar dhe sterlinës britaneze.

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare vazhduan të lehtësohen në TM2 2023 ndër tjera si rrjedhojë e rritjes së shqetësimeve për ngadalësim të kërkesës globale pas shtrëngimit të politikave monetare, reduktimit të pengesave në zingjirët e furnizimit, dhe ri-organizimit të lidhjeve tregtare globale pas fillimit të luftës në Ukrainë. Megjithatë, çmimet e mallrave akoma mbesin të larta dhe vazhdojnë të reflektohen në çmime të larta të konsumit.

Çmimi i naftës së papërpunuar brent sipas Bankës Botërore arriti mesatare prej \$78.2 për fuçi në TM2 2023, duke shënuar rënie prej 30.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (\$112.7 për fuçi në TM2 2022) (grafik 1). Ndërsa, në raport me tremujorin paraprak, çmimet e naftës shënuan rënie prej 3.9 përqind (\$81.4 për fuçi në TM1 2023). Megjithatë, trajektorja e çmimeve të naftës ishte e luhatshme përgjatë tremujorit të dytë ku dinamikat u udhëhoqën nga rënia e kërkesës për naftë dhe reduktimi i ofertës globale. Marrë parasysh pritet për ngadalësim të kërkesës globale përgjatë vitit 2023 dhe rënien në çmimet e naftës, OPEC+ njoftoi për reduktimin e sasisë së prodhimit të naftës për 1.7 milion fuçi në ditë nga muaji maj deri në fund të vitit 2023, që ndikoi në rritjen e çmimit të naftës në \$84.1 për fuçi në prill 2023. Megjithatë, ngadalësimi i kërkesës globale dhe rritja e pasigurive në sistemin financiar në ShBA ndikuan që çmimi i naftës të bie në

mesatare prej rreth \$75 për fuçi në maj dhe qershor 2023. Ndërsa, rritja e shqetësimeve rreth tkurrjes së ofertës globale të naftës pas njoftimit të Arabisë Saudite për zgjatjen e reduktimit të prodhimit prej 1 milion fuçi në ditë përgjatë muajit gusht, ndikoi në rritjen e çmimeve të naftës në \$80.1 për fuçi në korrik.


Çmimet e gazit natyror në Evropë vazhduan të shfaqin prirje rënese duke shënuar rënie prej 32.8 përqind kundrejt tremujorit paraprak mbështetur nga kushtet e lehta klimatike që ndikuan në uljen e konsumit të gazit natyror për ngrohje, importi i gazit natyror të lëngshëm nga SHBA-të që zbuti shqetësimet rreth sigurisë së furnizimit, si dhe nga masat e ndërmarra nga BE për rritje të efikasitetit dhe ruajtje të energjisë. Po ashtu, çmimet e gazit natyror shënuan rënie prej 64.2 përqind kundrejt TM2 2022 kur çmimet e gazit natyror në Evropë arritën mesatare prej \$31.6/mmbtu si pasojë e luftës në Ukrainë. Lehtësimi në çmimet e gazit natyror ndikoi edhe në rënie të thëngjillit dhe plehut artificial që shënuan rënie mesatare prej 57.4 dhe 51.7 përqind respektivisht në TM2 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve shënoi rënie prej 7.6 përqind krahasuar me tremujorin paraprak kur ishte evidentuar rritje e çmimeve të metaleve për shkak të rihapjes së ekonomisë së Kinës dhe pritshmërive për rritje të kërkesës për metale pas politikave mbështetëse të Kinës për sektorin e ndërtimit (grafik 2). Megjithatë, kërkesa për metale ishte e fokusuar në xehet e hekurit nga sektori i çelikut në Kinë, ndërsa çmimet e metaleve tjera vazhduan të shënojnë rënie pasi rritja ekonomike rezultoi të nxitet kryesisht nga sektori i shërbimeve. Kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak, indeksi i çmimeve të metaleve shënoi rënie prej 17.8 përqind e që mund t'i atribuohet ngadalësimit të rritjes ekonomike globale dhe përkeqësimit të perspektivës ekonomike, si dhe përmirësimit të ofertës pas rënies së çmimeve të energjisë.

Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara shënoi rritje prej 5.8 përqind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Çmimet e argjendit dhe platinës shënuan rritje vjetore prej 6.9 respektivisht 7.1 përqind nxitur nga rritja e kërkesës industriale për këto metale. Ndërsa, çmimi i arit shënoi rritje vjetore prej 5.8 përqind duke arritur çmimet më të larta historikisht në muajt prill dhe maj si pasojë e sfidave në sistemin bankar në SHBA dhe dobësimin të dollarit amerikan. Rritja e çmimeve të metaleve të çmuara u evidentua edhe kundrejt tremujorit paraprak kur indeksi i metaleve të çmuara shënoi rritje prej 5.2 përqind.


Në TM2 2023, indeksi i çmimeve të ushqimit sipas FAO shënoi rënie relativisht të lehtë prej -3.3 përqind krahasuar me tremujorin paraprak (grafik 3). Ndërsa, kundrejt TM2 2022 çmimet e ushqimit shënuan rënie prej 20.6 përqind nxitur nga rënia vjetore e çmimeve të drithërave (-23.1 përqind) dhe vajrave (-46.3 përqind) si rezultat i mbarëvajtjes së marrëveshjes mes Rusisë dhe Ukrainës për eksportin e drithërave nga Ukraina në

Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Banka Botërore.


Grafik 2. Çmimet e metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara



Burimi: Banka Botërore.

tregjet ndërkombëtare dhe rritja e rendimentit të misrit dhe grurit në botë. Rënie vjetore u shënuar edhe në çmimet e bulmetit (-19.0 përqind) dhe mishit (-4.8 përqind), ndërsa çmimet e sheqerit pasi arritën çmimet më të larta brenda 12 viteve të fundit në maj dhe qershor filluan të ndjekin trend rënës në korrik si rezultat i përmirësimit në të korrurat në Brazil dhe ngadalësimit të kërkesës globale për sheqer. Përkundër këtyre lehtësimeve në TM2 2023, mos vazhdimi nga ana e Rusisë i marrëveshjes për eksportin e drithërave nga Ukraina dhe bombardimi i porteve në Detin e Zi dhe në Danub në korrik 2023 ndikoi në rritjen e çmimit të drithërave dhe vajrave në tregjet ndërkombëtare, ndërsa ndalimi i eksportit të orizit jo-basmat nga India ndikoi në rritjen e çmimit të orizit në korrik duke shtuar kështu presionet inflacioniste në çmimet e ushqimit veçanërisht për tregjet e reja dhe ekonominë në zhvillim.

Grafik 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Ekonomia e Kosovës

Rritja Ekonomike

Aktiviteti ekonomik në Kosovë, sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ka shënuar rritje reale prej vetëm 2.0 përqind në TM2 2023. Rritja më e ngadalësuar e aktivitetit ekonomik i'u atribua kontributit negativ të eksporteve neto prej 2.5 përqind, ndërkohë që konsumi dhe investimet kontribuan pozitivisht në rritjen reale të BPV-së me 3.8 përkatësisht 0.7 pikë përqindje (grafik 4).

Grafik 4. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.


Konsumi ka shënuar rritje prej 3.7 përqind në TM2 2023, që është një rritje më e lartë krahasuar me tremujorin paraprak dhe tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja më e lartë e konsumit mund t'i atribuohet rritjes së remitencave, kredive konsumuese, kompensimit të punëtorëve, konsumit publik, etj., por edhe ngadalësimit të rritjes së çmimeve të konsumit. Investimet shënuan rritje prej 2.0 përqind që po ashtu është rritje më e lartë krahasuar me tremujorët paraprak. Rritja e investimeve të përgjithshme ishte kryesisht rezultat i rritjes së investimeve publike por edhe kredive investuese. Për sa i përket tregtisë së jashtme, eksportet neto kanë thelluar deficitin tregtar për 6.7 përqind në TM2 2023. Rritja e deficitit tregtar ka ardhur si rezultat i rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve prej 6.3 përqind, ndërsa eksporti i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 5.9 përqind.

Rritja e aktivitetit ekonomik në TM2 2023 është mbështetur kryesisht nga rritja e vlerës së shtuar në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (3.7 përqind), sektorin industrisë përpunuese (3.4 përqind), bujqësisë (2.8 përqind), tregtisë (2.4 përqind), etj. Të dhënat e qarkullimit të bizneseve konfirmojnë këtë rritje, ku qarkullimi në sektorin e tregtisë ka shënuar rritje prej 5.3 përqind, në sektorin e

industrisë përpunuese 2.1 përqind, etj. Sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit ka shënuar një rritje të dukshme prej 18.5 përqind.

Aktiviteti ekonomik u reflektua në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, që arriti në 3,086 ndërmarrje në TM1 2023, gjegjësisht 9.0 përqind më shumë krahasuar me TM1 2022. Sektori i tregtisë, prodhimit, ndërtimitarisë, aktiviteteve profesionale, hotelarisë dhe sektorë të tjerë regjistruan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara. Këto sektorë treguan një rritje të ndjeshme në numrin e ndërmarrjeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 (grafik 5). Në anën tjetër, gjatë TM1 2023, u mbyllën 446 ndërmarrje, që përfaqëson një zvogëlim prej 9.9 përqind krahasuar me TM1 2022.

Grafik 5. Numri i ndërmarrjeve të reja




Parashikimet e BQK-së për gjysmën e dytë të vitit 2023 sugjerojnë për një rritje prej 3.7 përqind në TM3 dhe 4.3 përqind në TM4 2023. Investimet e përgjithshme, konsumi publik si dhe eksporti i shërbimeve, i ndërlidhur me shpenzimet e diasporës, pritet të jenë shtytësit kryesor të rritjes, ndërsa pritjet për rënie të eksportit të mallrave pritet të ndikojnë negativisht aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.

Çmimet

Shkalla mesatare vjetore e inflacionit në TM2 2023 u ngadalësua në 4.2 përqind nga 9.9 përqind sa ishte në tremujorin paraprak si rrjedhojë e efektit të bazës dhe lehtësimeve në zingjirët e furnizimit dhe çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare. Përderisa u evidentua rritje e ngadalësuar në çmimet e ushqimit, mallrave jo energjetike dhe shërbimeve, ngadalësimi i inflacionit në 2.4 përqind në fund të TM2 2023 u ndikua veçanërisht nga rënia e çmimeve të energjisë, gjegjësisht karburanteve.

Grafik 6. Kontributi i nëngrupeve përkatëse në IÇK



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Çmimet e ushqimit shënuan rritje vjetore prej 9.7 përqind në TM2 2023, që paraqet ngadalësim të rritjes së çmimeve të ushqimit kundrejt rritjes vjetore prej 17.6 përqind në tremujorin paraprak. Rritja më e lartë vjetore u evidentua në çmimet e perimeve (13.6 përqind), prodhimeve ushqimore (13.2 përqind), qumështit, djathit dhe vezëve (12.6 përqind), sheqerit, reçelit, mjaltës, çokolatave dhe ëmbëlsirave (11.9 përqind), bukës dhe drithërave (10.3 përqind) e të tjera, ndërsa u shënuar rënie në çmimet e vajrave dhe yndyrave prej 9.7 përqind (grafik 6).

Çmimet e energjisë elektrike dhe lëndëve tjera djegëse në kuadër të kategorisë së strehimit shënuan rritje mesatare vjetore prej 7.9 përqind në TM2 2023, duke u ngadalësuar krahasuar me tremujorin paraprak (12.8 përqind në TM1 2023) si rezultat i kushteve të favorshme klimatike dhe ngadalësimit të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e transportit shënuan rënie vjetore prej 7.8 përqind në TM2 2023 me nënkategorinë e përdorimit të pajisjeve për transport personal që regjistroi rënie prej 17.5 përqind kundrejt rritjes prej 3.3 përqind në TM1 2023, si rrjedhojë e rënies së çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare. Sikurse në tremujorin paraprak, edhe në TM2 2023 rritja më e lartë vjetore në kuadër të kategorisë së transportit u shënuar në çmimet e shërbimeve të transportit (11.4 përqind) kategori kjo që po ashtu shënoi ngadalësim krahasuar me tremujorin paraprak (12.3 përqind).


Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM2 2023 ishte 3.4 pikë përqindje, me kontributin më të lartë të shënuar nga rritja e çmimeve të qumështit, djathit dhe vezëve prej 1.0 pikë përqindje, bukës dhe drithërave prej 0.9 pikë përqindje, mishit prej 0.7 pikë përqindje, e të tjera. Ndërsa, kontributi i transportit në inflacionin e përgjithshëm në TM2 2023 ra në -1.5 pikë përqindje (rënie nga 1.1 pikë përqindje në TM1 2023), e që u përcaktua kryesisht nga nënkategoria përdorimi i pajisjeve për transportin personal ku përfshihet pjesa më e madhe e karburanteve.

Ndërsa, kontributi i çmimeve të mallrave tjera jo energjetike shënoi rënie prej 0.3 pikë përqindje duke arritur në 1.0 pikë përqindje në TM2 2023 krahasuar me tremujorin paraprak kryesisht si rezultat i ngadalësimit të çmimeve të pijeve alkoolike dhe duhanit si dhe blerjes së automjeteve. Ndërsa, kontributi mesatar tremujor i shërbimeve në gjithsej IÇK-në u zvogëluar në 1.1 pikë përqindje (nga 1.4 pikë përqindje në TM1 2023) pas ngadalësimit të rritjes së çmimeve të shërbimeve hoteliere, shërbimeve për mirëmbajtjen e zakonshme të shtëpisë, shërbimeve të transportit, e të tjera.

Inflacioni bazë në TM2 2023 shënoi rritje vjetore prej 4.6 përqind, që kundrejt tremujorit paraprak paraqet ngadalësim prej 1.2 pikë përqindje (grafik 7). Në pjesë të madhe kontributi në inflacionin bazë u shënuar nga kategoria 'orendi, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të shtëpisë' me 1.3 pikë përqindje dhe nga kategoria 'shërbime të transportit' me 1.0 pikë përqindje. Sidoqoftë, inflacioni bazë vazhdon të ndjekë trend rënës, megjithëse me ritëm të ngadalshëm, duke u ngadalësuar në 3.4 përqind në korrik 2023.


Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe shkalla e lartë e pjesëmarrjes së këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që shkalla e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara. Në TM2 2023, 3.0 pikë përqindje të inflacionit në Kosovë ishte importuar, ndërsa 1.2 pikë përqindje u gjenerua nga presionet e brendshme inflacioniste (grafik 9). Si rezultat i lehtësimeve të vazhdueshme të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, inflacioni i importuar në TM2 2023 tregon për ngadalësim kundrejt tremujorit paraprak, që po ashtu u pasqyrua pjesërisht në frenimin e inflacionit të brendshëm.

Grafik 7. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Grafik 8. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Pasqyrimi i ecurisë së çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare në çmimet e importit në Kosovë përmbledhet përmes indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) i cili në TM2 2023 shënoi rritje vjetore prej 5.0 përqind, që paraqet ngadalësim kundrejt rritjes vjetore prej 8.6 përqind në TM1 2023. Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, kategoritë me peshën më të lartë në kuadër të këtij indeksi që përfshijnë i) artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhanin, dhe ii) pajisjet e makinerisë dhe ato elektrike shënuan rritje vjetore prej 8.3 përqind dhe 3.2 përqind respektivisht, ndërsa i) metalet bazë dhe artikujt përkatës dhe ii) produktet minerale shënuan rënie vjetore prej 5.9 respektivisht 3.2 përqind. Ndërsa, në raport me tremujorin paraprak, IÇIMP shënoi rritje prej 1.1 përqind, si pasojë e përshpejtimin të vazhdueshëm të çmimeve të i) produkteve bimore, ii) artikujve ushqimorë të përgatitur, pijeve dhe duhanit, iii) pajisjeve të makinerisë dhe pajisjeve elektrike, iv) mjeteve të transportit, e të tjera.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) rezultoi në rënie prej 0.9 përqind në TM2 2023 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak si rezultat i rënies së çmimit të i) nxjerrjes së xehes së metalit (14.9 përqind rënie vjetore) ii) prodhimit të energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-12.9 përqind), iii) prodhimit të mjeteve motorike (-5.2 përqind), metaleve (-4.5 përqind), si dhe ngadalësimit të çmimeve të komponentëve tjerë me peshë të konsiderueshme në IÇP si prodhimi i produkteve minerale jometalike, përpunimi i produkteve ushqimore, dhe prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës.

Krahasuar me tremujorin paraprak IÇP rezultoi me rënie prej 0.1 përqind kryesisht si pasojë e rënies së çmimit të nxjerrjes së xehes së metalit, çmimit të përpunimit të produkteve ushqimore, prodhimit të pijeve, prodhimit të produkteve minerale jometalike, e të tjera. Në anën tjetër, u evidentua rritje mujore prej 3.0 përqind në çmimet e prodhimit të energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimi me ajër të kondicionuar.

Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) shënoi rritje vjetore prej 1.0 përqind në TM2 2023, nxitur nga rritja e çmimeve të makinerive (8.2 përqind rritje vjetore), transportit (3.5 përqind), pagave (3.1 përqind), dhe kostove tjera (4.2 përqind). Në anën tjetër, në raport me TM1 2023 u evidentua rënie e IKN prej 0.1 përqind kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të materialeve ndërtimore, si komponenta me peshën më të lartë në IKN, dhe kostove tjera, ndërsa u shënuar rritje në çmimet e materialeve tjera, pagave, makinerive, transportit, dhe energjisë.

Lidhur me perspektivën e inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në TM3 2023 të ngadalësohet në 2.7 përqind, dhe për vitin 2023 në 4.8 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë lehtësimet e vazhdueshme të pengesave në zinxhirët e furnizimit, trendin zbritës të inflacionit në eurozonë, transmetimin e shtrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën e brendshme, e të tjera. Sidoqoftë, rreziqet e ndërlydhura me inflacionin anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit si pasojë e luftës në Ukrainë, rritje të çmimeve të ushqimit pas shkeljes së marrëveshjes nga ana e Rusisë për eksport të drithërave nga Ukraina, rritje të çmimit të naftës në tregjet e huaja dhe zvogëlim të sasisë së prodhimit nga OPEC+, zhvendosje të pritjeve për inflacionin, presione për rritje të pagave, e të tjera.


Sa u përket pritjeve të bankave për inflacion vjetor në Kosovë për vitin 2023, këto janë ulur në 4.8 përqind në gusht nga pritjet për inflacion vjetor prej 6.4 përqind në qershor 2023.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ në TM2 2023 arritën vlerën neto prej 682.5 milionë euro, duke paraqitur një rritje vjetore prej 16.4 përqind. Gjithashtu, shpenzimet buxhetore² shënuan rritje prej 17.1 përqind dhe arritën vlerën prej 619.5 milionë euro. Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej 62.9 milionë euro.

Të hyrat tatimore arritën vlerën prej 621.3 milionë euro duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 17.2 përqind më shumë krahasuar me TM2 2022. Në kuadër të të hyrave tatimore, pothuajse të gjitha kategoritë shënuan rritje. Rritja më e lartë është vërejtur tek të hyrat tatimore direkte, që arritën vlerën prej 144.2 milionë euro apo 24.8 përqind më shumë se në TM2 2022. Rritja e të hyrave tatimore direkte që kryesisht realizohen nga Administrata Tatimore e Kosovës, ishte si rezultat i përmirësimit të mbledhjes së të hyrave, zvogëlimit të hendekut tatimor, forcimit të përmbushjes vullnetare nga ana e tatimpaguesve, etj. Brenda kësaj kategorie, tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore, shënoi rritje vjetore prej 18.8 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 18.0 përqind. Të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 11.0 përqind, duke arritur vlerën prej 488.0 milionë euro. Rritja e të hyrave tatimore indirekte, si kategoria kryesore e të hyrave buxhetore, kishte të bënte kryesisht me normën e lartë të inflacionit, i cili edhe pse është ulur ndjeshëm vazhdon të mbete i lartë. Në kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat nga TVSH-ja dhe detyrimi doganor shënuan rritje prej 9.2 përkatësisht 12.7 përqind, duke u ndikuar dukshëm nga rritja e çmimeve. Edhe tatimi mbi akcizën shënoi rritje të ndjeshme prej 15.1 përqind, pavarësisht ngadalësimit të rritjes së importit të mallrave (grafik 9). Përveç të hyrave tatimore, **edhe të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 9.0 përqind dhe arritën vlerën 61.2 milionë euro.** Në kuadër të të hyrave jo-tatimore, të hyrat nga qeveria qendrore arritën vlerën prej 35.7 milionë euro duke shënuar rritje prej 10.9 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje për 4.2 përqind dhe arritën vlerën prej 15.1 milionë euro.

Grafik 09. Struktura e të hyrave tatimore



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje për 6.6 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale u dyfishuan. Në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet për paga shënuan rritje për 16.1 përqind dhe arritën vlerën prej 191.1 milionë euro, shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje për 24.2 përqind dhe arritën vlerën 96.1 milionë euro, ndërsa shpenzimet për subvencione dhe transfere shënuan rënie për 5.9 përqind dhe arritën vlerën prej 222.1 milionë euro. Shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 114.8 përqind duke arritur vlerën prej 110.2 milionë euro.

Raporti i borxhit ndaj BPV-së ishte 17.3 përqind në TM2 2023, krahasuar me 20.8 përqind në TM2 2022. Kjo ulje ishte si rezultat i përmirësimit të bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritjes së BPV-së nominale, e cila zvogëlon raportin e borxhit ndaj BPV-së. Ky nivel i borxhit publik është larg nga pragu i paraparë me ligj

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi si dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim si dhe pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve.


prej 40 përqind e BPV-së si dhe mesatares së vendeve të rajonit. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.67 miliardë euro në TM2 2023, duke shënuar rënie për 2.5 përqind krahasuar me TM2 2022. Zvogëlimi i borxhit publik kishte të bënte me uljen e borxhit të brendshëm publik me 11.2 përqind, duke arritur në 1.0 miliardë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 14.7 përqind dhe arriti në 663.9 milionë euro. Borxhi i jashtëm publik përbëhet nga detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (36 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (14 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (8 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i brendshëm përbëhet kryesisht nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj fondeve pensionale (48 përqind), bankave komerciale (22 përqind), institucioneve publike (22 përqind), etj.

Sektori i jashtëm

Llogaria rrjedhëse në TM2 2023 ka arritur në 328.0 milionë euro (331.5 milionë euro në TM2 2022).

Dinamikat në llogarinë rrjedhëse në periudhën prill-qershor të vitit 2023 kanë vazhduar të përcaktohen kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave, komponentë e cila u përkeqësua nga rritja e importit të mallrave. Ndërkohë në po të njëjtën periudhë kohore, të ardhurat parësore, dytësore dhe shërbimet ndikuan në zvogëlimin e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse (grafik 10).


Grafik 10. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK.

Bilanci tregtar i mallrave në Kosovë në TM2 2023 ka shënuar rritje vjetore të deficitit tregtar prej 4.7 përqind, duke arritur në 1.22 miliard euro. Arsyeya kryesore e rritjes së deficitit tregtar ndërlidhet me vlerën e lartë të importit të mallrave, dinamikë që kryesisht është ndikuar nga rritja e sasisë së mallrave të importuara. Ekonomia e Kosovës rezulton të ketë importuar në vlerë prej 1.43 miliard euro, deri sa po në të njëjtën periudhë, është eksportuar mallra në vlerë prej 210.7 milionë euro. Eksportet kanë mbuluar vetëm 14.7 përqind të importeve, respektivisht 1:6.8 raporti tregtar (grafik 11).

Grafik 11. Bilanci tregtar i mallrave




Burimi: ASK.

Vlera e përgjithshme e eksportit në TM2 2023 ishte 210.7 milionë euro, një rënie prej 9.1 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërkohë që struktura e mallrave sipas kategorive mbetet e pa ndryshuar, rënia e eksporteve në TM2 2023 u ndikua kryesisht nga rënia e shënuar në eksportin e metaleve bazë për 27.6 përqind, kategori që shënoi vlerën prej 45.8 milionë euro (63.3 milionë euro në TM2 2022). Kjo dinamikë kryesisht korrespondon me dobësimin e kërkesës në tregun e jashtëm të metaleve. Në rënie e eksportit ndikoi edhe kategoria e produkteve të plastikës dhe gomës (16.7 përqind), që shënoi vlerën prej 29.6 milionë euro (35.5 milionë euro në TM2 2022) (grafik 12).

Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në TM2 2023 ishin: Ballkani Perëndimor me një pjesëmarrje prej 41.8 përqind e gjithsej mallrave të eksportuara, dhe vendet BE-së prej 30.5 përqind.


Vlera e importit të mallrave në TM2 2023 arriti në 1.43 miliard euro, një rritje vjetore prej 2.5 përqind. Rritja e lehtë e importit të mallrave u ndikua nga sasia dhe pesha e përgjithshme, duke shënuar rritje vjetore prej 7.3 dhe 8.2 përqind. Struktura e kategorive të mallrave të importuara vazhdon të dominohet nga importi i produkteve minerale, artikujt ushqimorë dhe makineritë përfshirë pajisjet shtëpiake. Pjesëmarrja sipas kategorive kryesore të importit u dominua nga kategoria e mallrave të ndërmjetme prej 46.8 përqind, mallrave konsumuese prej 33.2 përqind, ndërsa kategoria e mallrave kapitale mbetet e ulët prej 10.2 përqind e importit të përgjithshëm. Sipas kategorive kryesore ekonomike, mallrat e ndërmjetme shënuan rënie prej 8.4 përqind, e ndikuar kryesisht nga dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërsa kategoria e mallrave kapitale dhe konsumuese shënuan rritje vjetore prej 6.4 dhe 8.5 përqind e ndikuar kryesisht nga rritja e kërkesës në vend. Rreth 42.9 përqind e importeve të mallrave ka ardhur nga vende të Bashkimit Evropian (614.4 milionë euro), ndër të cilat peshën kryesore vazhdon ta ketë Gjermania me 13.4 përqind të gjithsej importeve. Nga vendet e rajonit, Kosova importoi 17.3 përqind të importit të përgjithshëm apo 247.6 milionë euro. Ndërkohë, importi i mallrave nga Turqia ka arritur shumën prej 210.3 milionë euro apo 14.7 përqind e gjithsej importeve (grafik 13).

Garfik 12. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro




Burimi: BQK.

Garfik 13. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.

Garfik 14. Bilanci i shërbimeve



Burimi: BQK.

Shërbimet kanë vazhduar të rrisin kontributin pozitiv në kuadër të llogarisë rrjedhëse, me një rritje vjetore të bilancit pozitiv prej 24.6 përqind dhe arritur vlerën prej 292.2 milionë euro në TM2 2023. Eksporti i shërbimeve i'u atribua kryesisht rritjes së shërbimeve në kategorinë e udhëtimit prej 16.8 përqind, kategori që arriti vlerën prej 404.5 milionë euro, dhe kategoria e shërbimeve kompjuterike duke shënuar rritje prej 44.0 përqind, duke shënuar vlerën 75.0 milionë euro (52.1 milionë euro në TM2 2022). Në


anën tjetër, rritja e importit të shërbimeve i'u atribua rritjes së komponentëve së udhëtimit dhe transportit, e që përbejnë 66.3 përqind e përgjithshme e importit të shërbimeve (grafik 14).

Bilanci i të ardhurave parësore shënoi rritje prej 28.0 milionë euro në TM2 2023, duke arritur vlerën prej 38.7 milionë euro (10.7 milionë euro në TM2 2022). Rënia e të ardhurave parësore u ndikua kryesisht nga bilanci i të ardhurave nga investimet, si pasojë e kthimit të dividendes në vlerë prej 69.2 milionë euro nga investimet direkte në periudhën prill-qershor 2023. Ndërsa, bilanci i të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve ka shënuar rritje prej 12.3 përqind, e ndikuar nga rritja e të hyrave nga punëtorët rezident jashtë vendit (grafik 15).

Vlera e remitencave të pranuar në TM2 2023 ka arritur në 363.8 milionë euro, rritje prej 15.8 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e remitencave sipas shteteve mbetet e pa ndryshuar: Gjermania që ka një pjesëmarrje prej 37.4 përqind e remitencave të dërguara, Zvicra 18.0 përqind dhe SHBA-të 7.4 përqind. Dërgesat e emigranteve sipas kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) kanë shënuar rritje në vlerë prej 29.4 milionë euro, ndërsa është shënuar rritje prej 20.2 milionë euro e dërgesave në kanale jo formale. Duke konsideruar që pjesa me e madhe e remitencave të pranuar janë me origjinë nga vendet e eurozonës (rreth 60.0 përqind), ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë mund të ketë implikime mbi këtë të hyrë për ekonominë e Kosovës (grafik 16).


Investimet e huaja direkte në TM2 2023 rezultojnë të kenë shënuar rënie prej 12.5 përqind, duke arritur vlerën prej 184.4 milionë euro. Rënia IHD-ve është evidentuar kryesisht në sektorët e patundshmërisë, ndërtimitarisë dhe sektorin e xehetarisë përfshirë guroret. Sektori i patundshmërisë mbulon 60.0 përqind e përgjithshme të IHD-ve apo 110.6 milionë euro për periudhën prill-qershor 2023. Investimet e huaja direkte të rezidenteve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rritje në periudhën prill-qershor 2023, duke arritur vlerën prej 53.1 milionë euro (50.7 milionë euro në prill-qershor 2022), investime të destinuar në vendet e rajonit e të orientuara kryesisht në sektorin e patundshmërisë (grafik 17).

Grafik 15. Bilanci i të ardhurave parësore




Burimi: BQK.

Grafik 16. Remitancat



Grafik 17. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Sistemi financiar

Përkundër sfidave nga rreziqet më të larta me të cilat u përballë ekonomia, si inflacioni i rritur dhe perspektiva më e dobët ekonomike, sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm të përshpejtuar.

Asetet e sistemit financiar në vend përshpejtuan rritjen vjetore për 6.4 pikë përqindje kundrejt një viti më parë, dhe vlera e tyre arriti në 10.2 miliardë euro në fund të qershorit 2023. Të gjithë sektorët përbërës u karakterizuan me rritje të përshpejtuar vjetore të aseteve (grafik 18).

Sektori bankar në qershor 2023 përfaqësoi 67.5 përqind të gjithë aseteve të sistemit financiar, duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e gjithë aseteve të sistemit (grafik 19). Sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, fondet pensionale, shënuan rritje më të përshpejtuar të aseteve krahasuar me një vit më parë (grafik 19). Sektorët tjerë, ai mikrofinanciar, i sigurimeve dhe ndihmësve financiar shënuan shkallë më të lartë të rritjes dyshifrore, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në rritjen e gjithë aseteve të sistemit financiar, përkundër peshës së ulët përbërëse që kanë.


1. Sektori bankar

Sektori bankar dhe sistemi financiar në përgjithësi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të jashtme si rezultat i tensioneve gjeopolitike që mund të përshkallëzohen në Evropën Lindore, kurse inflacioni mbetet rreziku kryesor. Përkundër që situatat që e kanë nxitur inflacionin janë zbutur dhe politikat monetare të bankave qendrore janë duke prodhuar efekt, pasojat e inflacionit të transmetuara në segmentet tjera janë ende aktuale, inflacioni është persistent (i qëndrueshëm) dhe me rënie të ngadalshme. Sektori bankar në Kosovë për shkak të peshës, strukturës dhe kompleksitetit të ulët nuk ka ekspozim të lartë me sektorin e jashtëm dhe pasojat potenciale të ndonjë krize apo paniku në sektorin financiar nuk do të rrezikonin sektorin bankar në mënyrë direkte. Kurse, efektet negative që burojnë nga inflacioni kanë ndikim më të drejtpërdrejt në tregun bankar vendor, dhe duhet të monitorohen indikatorët kryesor të shëndetit bankar.


Asetet

Asetet e sektorit bankar në qershor 2023 arritën vlerën 6.88 miliardë euro, që përkon me rritje të përshpejtuar vjetore prej 14.6 përqind krahasuar me rritjen 7.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 20). Kontributin kryesor në rritje e kishte zgjerimi i kreditimit si aktiviteti kryesor i sektorit bankar. Investimi në letrat me vlerë ishte komponenta e dytë që kontriboi në përshpejtimin e rritjes së aseteve, pasuar nga kategoria e mjeteve të mbajtura në bankat tjera. Të dy këto kategori të fundit shënuan rritje të përshpejtuar krahasuar me rënie vjetore në periudhën e njëjtë të vitit

Grafik 18. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Grafik 19. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje




paraprak. Kurse, zëri i parasë së gatshme dhe bilanci me BQK-në mbeti në nivelin e njëjtë me një vit më parë.

Kreditimi


Aktiviteti kreditues i sektorit shënoi rritje vjetore prej 14.5 përqind, që përkon me shkallë më të ulët të rritjes krahasuar me një vit më parë. Sipas Anketës së Kreditimit bankar, dinamikat e kreditimit edhe në tremujorin e dytë të vitit 2023, sikurse në TM1 2023, u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore kishte ndryshime marginale. Kërkesa kreditore për ndërmarrjet në përgjithësi u karakterizua me rritje, por më e ulët se në tremujorin paraprak, ndërsa oferta kreditore kishte lëvizje marginale negative. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, në shkallë të përafërt si për kreditë konsumuese dhe për ato hipotekare. Standardet kreditore u lehtësuan deri në një masë për kreditë për blerjen e shtëpive, ndërsa ato ndryshuan marginalisht për kreditë konsumuese. Dinamikat e kreditimit në gjysmën e parë të vitit 2023 përgjithësisht reflektojnë qasje më të kujdesshme të konsumatorëve në ndërmarrjen e borxheve shtesë në ambient të rritjes së kostos së jetesës dhe njëkohësisht, qasje dhe monitorim më të kujdesshëm të bankave në kredi-dhënie. Sipas anketës, shtytësi i aktivitetit kreditor në tremujorin vijues pritet të jetë kërkesa për kreditë konsumuese ngase kërkesa për kredi nga ndërmarrjet pritet të mbetet e pandryshuar, si dhe oferta kreditore nuk pritet të ndryshoj.

Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 12.9 përqind, që përkon me ngadalësim vjetor për 3.8 pikë përqindje (grafik 21). Ndërsa, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 16.8 përqind, që në krahasim me vitin paraprak paraqet ngadalësim të lehtë të rritjes prej 0.7 pikë përqindje. Për shkak të peshës më të lartë në gjithsej kreditë, segmenti i korporatave jofinanciare kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit të sektorit bankar (grafik 22).

Grafik 20. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Grafik 21. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Grafik 22. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje




Burimi: BQK.

Kreditë e reja në gjysmën e parë të vitit 2023 shënuan përgjysmim të shkallës së rritjes në 9.0 përqind nga 18.5 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sektori i ndërmarrjeve u karakterizua me ngadalësim të normës së rritjes vjetore të kredive të reja, ndërsa ai i ekonomive familjare shënoi rritje të përshpejtuar krahasuar me vitin paraprak (grafik 23).

Deri në qershor 2023, kreditë e reja të korporatave jofinanciare u rritën për 11.1 përqind krahasuar me rritjen 32.6 përqind në gjysmën e parë të vitit 2022. Kreditë me karakter investuese u rritën për 13.6 përqind, si dhe kreditë me karakter jo-investues shënuan rritje vjetore prej 11.6 përqind. Kreditë e reja për ekonomitë familjare shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 6.1 përqind. Në kuadër të segmentit të ekonomive familjare, kreditë e reja konsumuese shënuan rritje vjetore prej 10.6 përqind, nga rënia prej 6.1 përqind në gjysmën e parë të vitit 2022, ndërsa kreditë e reja hipotekare shënuan rënie vjetore prej 9.6 përqind, për dallim nga rritja prej 16.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Investimet e huaja direkte në sektorin e patundshmërisë gjithashtu treguan tendencë rënëse deri në muajin maj 2023. Kjo, së bashku me rënien e kredive hipotekare, mund të sugjerojnë për sentimentin në rënie për investim në patundshmëri, të ndikuar nga rritja e normave të interesit si dhe çmimeve të patundshmërieve.


Në kuadër të kredive për korporatat jo financiare, sektori i tregtisë është më i kredituari ndër vite, pasuar nga ai i prodhimit dhe i ndërtimitarisë, të cilët janë zgjeruar gradualisht në vitet e fundit duke rritur pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Në fund të qershorit 2023, kreditimi ndaj sektorit të tregtisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare (grafik 24), si rezultat i peshës së lartë në këtë segment si dhe rritjes vjetore prej 10.8 përqind (grafik 25). Sektori i prodhimitarisë, që në vitin e kaluar kishte peshën më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit për këtë segment, në qershor 2023 shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore prej 15.1 përqind nga 45.6 përqind një vit më parë kur edhe u mbështet nga masat subvencionuese të qeverisë në kuadër të pakos së rimëkëmbjes ekonomike. Kreditimi ndaj sektorit të ndërtimitarisë shënoi rritje vjetore më të ngadalësuar gjithashtu, prej 13.5 përqind në qershor 2023, nga 21.5 përqind një vit më parë. Në ngadalësimin e kreditimit për këtë sektor mund të ketë

Grafik 23. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 24. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 25. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

ndikuar edhe shkalla e lartë e inflacionit në vitin 2022 – rritjes së çmimit të materialeve ndërtimore që janë transmetuar në ngadalësimin e punimeve ndërtimore apo ndërprerjen e përkohshme të tyre. Sektori i bujqësisë, i cili është më së paku i kredituar nga bankat komerciale, u karakterizua me rritje prej 2.9 përqind, për dallim nga rënia prej 4.0 përqind në vitin paraprak.

1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake


Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet në depozitat e klientëve dhe kapitalit vetanak, konkretisht fitimit të mbajtur nga periudhat paraprake dhe fitimit të realizuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Të dy këto zëra përbëjnë 92.9 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit, ku 81.5 përqind përbëhen vetëm nga depozitat. Shtrengimi i politikave monetare në nivel global që ka ndikuar në rritjen e përgjithshme të normave të interesit, e reflektuar edhe në tregun vendor që nga gjysma e dytë të vitit 2022, u shoqërua me rritje të përforcuar të vlerës së gjithsej depozitave.

1.1.1 Depozitat

Vlera e stokut të depozitave në fund të qershorit 2023 arriti në 5.61 miliardë euro (grafik 26), që paraqet një rritje vjetore të përsheptuar prej 16.0 përqind, nga 8.0 përqind në qershor të vitit 2022. Depozitat e dy segmenteve të sektorit privat shënuan përsheptim të rritjes dhe përcaktuan trendin e rritjes të gjithsej depozitave. Për më tepër, edhe depozitat e arkëtuara prej korporatave publike dhe fondeve pensionale shënuan rritje të theksuar, duke kontribuar në normën më të lartë të rritjes në 14 vitet e fundit.


Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 11.6 përqind në qershor 2023 nga 11.0 përqind në vitin paraprak, zhvillim ky që është ndikuar nga rritja e normave të interesit në depozita. Në qershor 2023, vlera e depozitave të ekonomive familjare arriti në 3.80 miliardë euro, duke përcaktuar edhe trendin e përgjithshëm të gjithsej depozitave në sektorin bankar (grafik 27). Sa i përket nivelit të depozitave të reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare, ku përfshihen vetëm depozitat e afatizuara, gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 ato arritën vlerën prej 192.2 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 21.5 përqind, lehtësisht më e ulët krahasuar me rritjen vjetore të vitit paraprak prej 26.4 përqind (grafik 28).

Grafik 26. Stoku i gjithsej depozitave




Burimi: BQK.

Grafik 27. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 28. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Stoku i depozitave të korporatave jofinanciare në fund të qershorit 2023 arriti në 1.11 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 24.7 përqind nga 8.4 përqind në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Depozitat e reja të arkëtuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 nga ky segment u rritën në 92.8 milionë euro nga 43.0 milionë në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Shtrëngimi i kushteve të financimit nga masat e ndërmarra për kontrollim të inflacionit, ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të konkurrencës në vend për sigurimin dhe mbajtjen e depozitave; duke ofruar kushte më atraktive për depozitim të mjeteve kryesisht përmes rritjes së normave të interesit në depozita.

1.2 Normat e interesit


Normat e interesit në kredi dhe depozita të reja kishin shënuar rritje graduale, që nga fillimi i vitit të kaluar, të implikuara nga aplikimi i politikave të shtrënguara monetare nga bankat qendrore në luftën kundër inflacionit. Në tregun bankar normat e interesit në depozitat e reja janë ndikuar në nivel më të lartë se normat e interesit në kredi të reja. Në qershor të këtij viti, norma e interesit në kredi arriti në 6.5 përqind nga 6.0 përqind në qershor 2022, atëherë kur inflacioni u intensifikua dhe diskutimet mbi ndërhyrjen e politikës monetare kishin filluar. Poashtu shkalla mesatare e interesit në depozita u ngrit në 2.1 përqind nga 1.7 përqind në qershor 2022 dhe 1.9 përqind në shtator 2022, kur shqetësimet mbi ruajtjen e depozitave dhe rrezikun e likuiditetit u theksuan tutje. Margjina e interesit kredi-depozitë u zgjerua në 4.45 pikë përqindje nga 4.32 pikë përqindje për shkak të rritjes më të lartë të normës së interesit në kredi (grafik 29).

Grafik 29. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.

Grafik 29a. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burimi: BQK.

Dinamika e normave të interesit e ndikuar nga zhvillimet në nivel global, si dhe rritja e rrezikut të likuiditetit dhe pasigurive mbi zhvillimet në të ardhmen si pasojë e rritjes së presioneve inflacioniste, përveç që kanë shtyrë bankat në vend drejtë rritjes së normave të interesit në kredi e depozita, në të njëjtën kohë kanë ndikuar edhe në ndryshimin e strukturës së kredive sipas llojit të normave të interesit. Përderisa në vitin 2020 dhe 2021, kreditë me norma variable të interesit, që kryesisht përcaktohen nga lëvizjet e normës Euribor për marzhën shtesë, përbënin mesatarisht 16.5 përqind të portfolios kreditore dhe 19.6 përqind respektivisht, kjo

përbërje në vitin 2022 u rrit në 24.1 përqind dhe deri në qershor 2023 është ngritur tutje në 30.3 përqind (grafik 29a).

Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në qershor 2023 qëndroi në 6.8 përqind, për 0.7 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për sektorin e industrisë (6.4 përqind), ndërsa norma më e lartë mesatare e interesit ishte për sektorin e bujqësisë prej 6.8 përqind (grafik 30).

Norma mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare arriti në 6.1 përqind, për 0.2 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare në mesatare prej 5.4 përqind, duke qenë se konsiderohen me rrezik më të ulët kur kanë mbulesë me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit prej mesatarisht 6.3 përqind (grafik 31).


Normat e interesit në depozita filluan trendin rritës që nga muaji qershor i vitit 2022 duke arritur deri në mesatarisht 2.4 përqind në fund të vitit të kaluar. Në qershor 2023 norma mesatare e interesit në depozita arriti në 2.1 përqind, për 0.4 pikë përqindje më e lartë se në qershor 2022 por më e ulët për 0.3 pikë përqindje se në dhjetor 2022. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare është rritur për 0.4 pikë përqindje, në 2.5 përqind. Poashtu për ekonomitë familjare është rritur për 0.4 pikë përqindje, duke arritur në 1.9 përqind në qershor 2023 (grafik 32).

Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar deri në tremujorin e dytë të vitit 2023 realizoi profit neto prej 82.6 milionë euro, në nivel rekord në raport me periudhat e njëta të viteve paraprake. Rezultati i tillë financiar u arrit nga rritja më e lartë e të hyrave krahas rritjes së shpenzimeve (grafik 33).


Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 202.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 19.9 përqind (11.6 përqind deri në qershor 2022). Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor e kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 74.7 përqind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në

Grafik 30. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare




Burimi: BQK.

Grafik 31. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Grafik 32. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.

kredi kontribuuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit, posaqërisht në dy vitet e fundit. Për më tepër, të hyrat nga plasmanet me bankat janë rritur theksueshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë.

Ndërsa, kategoria e të hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore prej 6.1 përqind nga rritja prej 13.3 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 44.6 milionë euro në fund të qershor 2023.


Vlera e shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 119.9 milionë euro deri në qershor 2023. Me rritje më të përsheptuar vjetore u karakterizuan edhe shpenzimet duke u rritur përkatësisht për 18.3 përqind nga 6.1 përqind sa ishte deri në qershor të vitit të kaluar. Kontributin më të lartë në këtë rritje kishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative si dhe shpenzimeve të interesit. Kategoria me peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 59.2 përqind u rritën për 15.5 përqind nga viti paraprak (8.6 përqind rritje në vitin a kaluar), dhe arritën vlerën në 71.0 milionë euro në fund të qershor 2023. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit, për të përshtatur nivelin e pagave me ritmin e rritjes së inflacionit. Poashtu shpenzimet e interesit shënuan rritje vjetore prej 51.7 përqind nga rritja e shënuar në vitin paraprak prej 4.0 përqind, që i atribuohet rritjes së normave të interesit në depozita dhe njëkohësisht rritjes së stokut të depozitave.

Treguesit e shëndetit financiar

Sektorit bankar ndër vite ka arritur të siguroj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo-performuese. Gjendja e kënaqshme e këtyre indikatorëve i jep përparësi sektorit në absorbimin e goditjeve nga pasiguritë e shkaktuara nga krizat gjeopolitike, rritja e inflacionit dhe ngadalësimi ekonomik.


Cilësia kreditore shënoi përmirësim duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2021 deri në shtator të vitit të kaluar, ku vlera e kredive jo-performuese kishte trend rënës prej mesatarisht 2.5 përqind. Që nga tremujori i fundit i vitit 2022, trendi rënës ndërroi kahje, ku vlera e KJP-ve u rrit për 4.3 përqind dhe 8.3 përqind në fund të vitit 2022 dhe përkatësisht në fund të qershorit të vitit 2023. Vlera e kredive jo-performuese është rritur për rreth 7.3 milionë euro nga qershori i vitit të kaluar. Si raport ndaj kredive, KJP-të për segmentin e ekonomive familjare vazhdojnë të jenë të ulëta, prej 1.3 përqind. Ndërsa për segmentin e korporatave jofinanciare raporti i KJP-ve qëndroi në 2.5 përqind, dhe vlera e KJP-ve shënoi rritje vjetore për 3.9 përqind krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar. Me rritje të vlerës së KJP-ve u karakterizua sektori i energjisë dhe prodhimitarisë, që u rrit për 3.8 milionë euro dhe 3.4 milionë euro respektivisht, kurse si raport ndaj kredive u rrit për 7.0 pikë përqindje dhe 0.4 pikë përqindje, pra në nivelin 9.6 përqind dhe 1.8 përqind. Vlera e KJP-ve për sektorin e tregtisë u zvogëlua

Grafik 33. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Grafik 34. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmeria me provizione



Burimi: BQK.

për 2.2 milionë euro, ndërsa si raport ndaj kredive zbriti në 1.9 përqind nga 2.3 përqind. Ndërsa për sektorët e tjerë vlera dhe raporti i KJP-ve pësoi lëvizje marginale krahasuar me vitin paraprak.

Rritja më e theksuar e kreditimit në periudhën raportuese ndikoi që raporti i përgjithshëm i kredive joperformuese të sektorit bankar të zvogëlohet në 2.0 përqind, nga 2.1 përqind në qershor të vitit të kaluar. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëluar lehtësisht në 137.8 përqind, nga 145.7 përqind në qershor 2022, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive joperformuese se sa i vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (grafik 34).

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u rrit në nivelin prej 15.3 përqind nga 15.1 përqind sa ishte në qershor 2022, rezultat i rritjes më të theksuar të kapitalit krahasuar me asetet me peshë rreziku. Fitimi i bartur nga viti paraprak dhe ai i realizuar në tremujorin e dytë të vitit 2023 ka ndikuar që kapitali të shënoj rritje më të theksuar krahasuar me rritjen e aseteve me peshë rreziku (grafik 35).


Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra në qershor 2023 ishte 31.2 përqind, për 0.8 pikë përqindje më e ulët krahasuar me një vit më parë (grafik 36). Rënia, edhe pse marginale e raportit të likuiditetit, rezultoi për shkak të rritjes më të theksuar të detyrimeve afatshkurtëra prej 12.5 përqind krahasuar me rritjen e mjeteve likuide prej 9.7 përqind. Në kuadër të mjeteve likuide, investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja shënuan rritjen më të theksuar, pasuar nga depozitat dhe plasmanët në bankat e huaja. Ndërsa detyrimet afatshkurtëra janë rritur rezultat i rritjes së depozitave krahasuar me qershor të vitit 2022. Raporti kredi/depozitë ka zbritur në 84.1 përqind nga 85.2 përqind një vit më parë, rezultat i rritjes më të lartë të depozitave në raport me atë të kredive në periudhën e fundit.

Sektori pensional

Asetet e sektorit pensional rikuperuan ritmin e rritjes të viteve paraprake, pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë si rezultat i luhatjeve të mëdha në tregjet financiare ndikuar prej përkeqësimit të situatës gjeo-politike në Evropën Lindore. Sektori pensional deri në qershor 2023 shënoi kthim pozitiv nga investimet dhe të hyra në rritje nga kontributdhënësit.


Me pjesëmarrjen e dytë më të lartë në gjithsej asetet e sistemit financiar, asetet e fondeve pensionale u rritën me 11.2 përqind në fund të qershorit 2023, e që është dukshëm më e lartë se sa rritje për vetëm 5.5 përqind një vit më parë (grafik 37). Vlera e aseteve pensionale arriti në 2.54 miliardë euro, nga të cilat 99.6 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), dhe pjesa e mbetur nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja). Përderisa FKPK-ja shënoi rritje vjetore të aseteve prej 11.1 përqind, asetet e

Grafik 35. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Grafik 36. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-ja) shënuan rritje vjetore prej vetëm 6.6 përqind në qershor 2023.


Asetete FKPK-së kryesisht janë të investuara në tregun e jashtëm (69.7 përqind e portfolios investuese), në fonde të përbashkëta në vlerë prej 1.76 miliardë euro (apo 69.7 përqind e gjithsej asetëve të FKPK-së). Pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 488.4 milion euro apo 19.3 përqind e gjithsej portfolios investuese dhe certifikata të depozitit në sektorin bankar vendor në vlerë prej 128.9 milionë euro (5.1 përqind e gjithsej investimeve). Po ashtu edhe struktura e portfolios investuese e FSKP-ës është ngjashëm e diversifikuar me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, në aksione që përbëjnë 76.1 përqind të portfolios investuese dhe në letra me vlerë, që përbëjnë vetëm 3.8 përqind të gjithsej investimeve. Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përbëjnë 14.4 përqind të gjithsej portfolios investuese. Ndërsa pjesa e mbetur e mjeteve të mbajtura në vend (rreth 2.1 përqind) përbëhet nga paraja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale.

FKPK-ja u karakterizua me zvogëlim marginal të portfolios investuese në tregun e jashtëm krahas rritjes së investimeve në atë të brendshëm, kurse FSKP-ja rriti investimet në tregun e jashtëm, kundrejt tkurrjes së investimeve në sektorin e brendshëm. (grafik 37a).

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja deri në qershor 2023 arriti në 337.1 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.3 përqind, e ndikuar nga rritja e numrit të kontributdhënësve. Kurse, kthimi kumulativ bruto nga investimet deri në qershor 2023 arriti në 481.7 mijë euro kundrejt humbjeve në vlerë prej 801.6 mijë euro një vit më parë, e që ishte rezultat i turbulencave të krijuara në tregjet financiare, kryesisht shkakuar nga zhvillimet gjeo-politike në Evropën Lindore.


Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 15.9 përqind, duke arritur në 134.7 milionë euro. Rritja e lartë dyshifrore e kontributeve të arkëtuara ndër

Grafik 37. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK.

Grafik 37a. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP.

Grafik 38. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.


tjerash reflekton edhe rritjen e pagave të shërbyesëve civil, që ishte efektive nga fillimi i vitit 2023. Kurse, kthimi bruto në investime deri në qershor të vitit 2023 arriti vlerën prej 24.1 milionë euro kundrejt humbjeve në vlerë prej 161.6 milionë euro një vit më parë. Kthimi pozitiv në investime në gjysmën e parë të vitit 2023 reflekton përmirësimin e tregjeve financiare globale, veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit, e që u reflektua në performancën e fondit në sektorin e jashtëm (grafik 38).

Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve shënoi rritje dyshifrore për të dytin vit me radhë, rritje të konsiderueshme të primeve të shkruara dhe performancë financiare më të lartë krahasuar me vitet e fundit.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.9 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar në fund të qershorit 2023. Vlera e gjithsej asetëve në fund të qershorit 2023 arriti në 294.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 16.0 përqind (grafik 39). Zgjerimi i sektorit kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së rezervave teknike, që burojnë nga primet e shkruara si dhe kapitalit vetanak të siguruesëve. Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje krahasuar me gjendjen në qershor 2022, por që është më e ngadalësuar si rrjedhojë e nivelit më të ulët të borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 (emetime të reja vetëm gjatë periudhës janar-mars 2023).


Grafik 39. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Vlera e primeve të shkruara në fund të qershorit 2023 arriti vlerën prej 70.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.5 përqind. Rritja e primeve të shkruara reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të kategorisë 'sigurimi i sëmundjeve' në kuadër të sigurimit vullnetar dhe 'përgjegjësia motorike ndaj palës së tretë' në kuadër të sigurimit të detyrueshëm. Primet e shkruara ndaj sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më madhe, prej 54.5 përqind të gjithsej primeve të shkruara jo-jetë. Rritja e primeve në kuadër të 'sigurimit të sëmundjeve' (për 20.8 përqind) është indikacion pozitiv për rritje të numrit të qytetarëve që posedojnë sigurim (polica) shëndetësore. Për më tepër, edhe numri i policave për këtë kategori është rritur në 173.3 mijë sosh nga 115.8 mijë sa ishin në fund të qershorit 2022. Ndërsa, rritja e primeve të sigurimit të detyrueshëm reflekton kryesisht kategorinë e 'sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësia - MTPL e brendshme' dhe 'MTPL+', që shënuan rritje vjetore për 8.6 përkatësisht 15.8 përqind.

Grafik 40. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.


Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve deri në qershor 2023 arriti vlerën prej 36.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.2 përqind (5.5 përqind një vit më parë) (grafik 40). Vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja ka shënuar rënie prej 34.2 përqind, kurse

dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 26.3 përqind. Rritja e theksuar e dëmeve të paguara buroi nga segmenti 'jo-jetë', përkatësisht dëmeve të 'sigurimit nga zjarri dhe forcat e natyrës' dhe 'sigurimi i sëmundjeve'. Kategoria e 'përgjegjësive motorike ndaj palëve të treta' vazhdon të ketë peshën më madhe, prej 53.6 të gjithsej dëmeve të paguara nga segmenti 'jo-jetë', por që krahasuar me periudhën raportuese të një viti më parë, u rritën për vetëm 0.4 përqind. Sektori i sigurimeve në gjashtëmuorin e parë të vitit 2023 realizoi fitim në vlerë prej 5.9 milionë euro (2.5 milion euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë). Vlera më e lartë e fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar erdhi si rezultat i vlerës më të lartë të hyrave të arkëtuara nga primet e shkruara krahasuar me vlerën e shpenzimeve për dëmet të paguara.

Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar në gjysmën e parë të vitit 2023 shënoi rritje të përshpejtuar të aseteve, kryesisht ndikuar nga zgjerimi i kreditimit, financuar prej huamarrjeve dhe kapitalit vetanak. Sektori pothuajse ruajti nivelin e fitimeve të vitit të kaluar, kurse kreditë me probleme vazhdojnë të jenë të ulëta dhe mirë të provizionuara. Mirëpo, sektori mund të përballlet me kosto të rritura të financimit për shkak të rritjes së normave të përgjithshme të interesit si rezultat i politikave të shtrënguara monetare të aplikuara nga shumë banka qendrore për kontrollim të inflacionit. Këto dinamika, mund të reflektohen në rritje tutje të normave të interesit për kredi, për shkak të varësisë së madhe në financim të aktivitetit nga huatë e jashtme (61.5 përqind të detyrimeve dhe kapitalit).

Grafik 41. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Asetet


Asetet e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 20.0 përqind në qershor 2023, duke arritur vlerën prej 446.6 milionë euro në fund të periudhës (grafik 41). Në këtë rritje kontributin kryesor e kishte rritja e kreditimit dhe në masë më të ulët rritja e lizingjeve. Aktiviteti kreditor i sektorit vazhdon të mbështetet nga huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit të cilat u rritën për 20.0 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, kryesisht përmes fitimit të bartur ndër vite dhe atij të realizuar deri në qershor të vitit 2023.

Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar vazhdoi të rritet me ritëm të përshpejtuar për të dytin vit me radhë, duke arritur trendin e para pandemisë (2016-2019).

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje vjetore për 23.0 përqind në fund të qershorit 2023, përderisa stoku i tyre arriti në 321.5 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy segmentet e sektorit privat, korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare. Konkretisht, kreditimi ndaj

Grafik 42. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare




Burimi: BQK.

ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 18.6 përqind (rritje vjetore prej 18.2 përqind në qershor 2022), duke arritur vlerën 201.5 milionë euro në fund të qershorit 2023 (grafik 42). Stoku i kredive ndaj korporatave jo financiare arriti vlerën prej 120.0 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 31.2 përqind (rritje vjetore për 22.3 përqind në qershor 2022).

Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare sipas sektorëve të ekonomisë ka ndjekur trendin rritës, duke shënuar rritje në secilin sektor ekonomik (grafik 43). Për dallim nga sektori bankar, stoku i kredive ndaj segmentit të bujqësisë ka peshën më të madhe në gjithsej kreditimin e korporatave jofinanciare të IMF/IFJB-ve, prej 25.9 përqind.

Grafik 43. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Për më tepër, ky segment kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit ndaj korporatave jofinanciare (grafik 44), duke shënuar rritje vjetore prej 28.4 përqind në qershor 2023 dhe arritur vlerën prej 31.1 milionë euro. Në rritjen e kreditimit për segmentin e bujqësisë ndikim kishte edhe garancioni kreditor i ofruar nga FKGK-ja për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të.

Lizingjet


Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar (17.9 përqind). Aktiviteti i lizingjeve për të dytin vit me radhë shënoi rritje dyshifrore, dhe arritën vlerën në 79.9 milionë euro në fund të qershorit 2023 (grafik 45). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor vazhdojnë të kenë korporatat jofinanciare, përderisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i limituar.

Grafik 44. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Grafik 45. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në qershor 2023 ishte 19.0 përqind, për 0.1 pikë përqindje më e lartë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 46). Për dallim nga sektori bankar, që ka shkalla pothuajse trefish më të ulëta për shkak të kostos së ulët të financimit të aktiviteteve (përmes depozitave), IMF/IFJB-të kryesisht financohen nga kreditë e marra nga sektori i jashtëm, që kanë norma më të larta të interesit. Zhvillimet e fundit në sektorin financiar, përkatësisht rritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore, pritet të reflektohet në koston e financimit të sektorit dhe potencialisht, të përkthehet në rritje tutje të normës së interesit në kredi të ofruar nga ky sektor.

Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi rënie për 0.4 pikë përqindje, në 21.1 përqind. Sipas llojit të kredive, norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese u rrit për 1.3 pikë përqindje në 22.9 përqind. Kurse, kreditë hipotekare vazhdojnë të kenë normat më të ulëta të interesit, në mesatare prej 17.0 përqind në qershor 2023, krahasuar me vitin e kaluar shënoi rënie për 1.1 pikë përqindje.

Për korporatat jofinanciare, normat mesatare të interesit, u rrit për 0.9 pikë përqindje, në 15.9 përqind në qershor 2023 (grafik 47). Shkalla e interesit për kreditë për sektorin e bujqësisë dhe atë të industrisë u zvogëluan për 1.7 dhe 0.5 pikë përqindje përkatësisht, duke qëndruar në 17.8 përqind dhe 17.3 përqind respektivisht në fund të qershorit 2023. Kurse, kreditë ndaj sektorit të shërbimeve, që kanë kushtet më të favorshme të interesit, në fund të qershorit 2023 kishin normë të interesit prej 14.8 përqind, rritje vjetore prej 2.3 pikë përqindje.


Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar deri në qershor 2023 pothuajse arriti të ruaj nivelin e profitabilitetit të periudhës së njëjtë të një viti më parë, pavarësisht që sektori u përball me rritje të koston së financimit të aktiviteteve të saj. Në fund të qershorit 2023, ky sektor shënoi fitim neto në vlerë prej 8.2 milionë euro, për 0.6 milionë euro më e ulët se gjendja në fund të qershorit të një viti më parë (grafik 48).

Rritja më e theksuar e shpenzimeve për 25.1 përqind, krahasuar me rritjen më të ulët të hyrave për 14.6 përqind, ndikuan që sektori të ketë performancë financiare më të dobët se një vit më parë.


Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi, që paraqesin kategorinë dominues të të hyrave (91.3 përqind), shënuan rritje vjetore prej 18.6 përqind (16.7 përqind deri në qershor 2022), si rezultat i rritjes së theksuar të kreditimit në

Grafik 46. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Grafik 47. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.


dy vitet e fundit. Kategoria e të ardhurave nga jointeressi deri në qershor të vitit 2023 shënoi rënie vjetore prej 15.3 përqind (rritje për 57.7 përqind një vit më parë), si rezultat i rënies së kategorisë së të ardhurave tjera operative.

Në kuadër të shpenzimeve, rritja kryesisht i'u atribuua shpenzimeve të personalit dhe administrative. Kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 16.1 përqind (22.5 përqind një vit më parë), që mund ti atribuohet rritjes së shpenzimeve për paga të punëtorëve në korrigjim me inflacionin, dhe në masë më të ulët atyre administrative. Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit (24.8 përqind të gjithsej shpenzimeve) shënoi rritje vjetore prej 44.2 përqind në fund të qershorit 2023 (-0.1 përqind një vit më parë), duke reflektuar rritjen e nivelit të huazimeve prej sektorit të jashtëm, si dhe rritjes së kostos së financimit nga rritja e normave të interesit. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.4 pikë përqindje, në 1.8 përqind. Përderisa, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në qershor 2023 është rritur në 151.7 përqind (144.5 përqind në qershor 2022) (grafik 49).

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës


Për herë të parë që nga fillimi i emetimit të letrave me vlerë nga Departamenti i Thesarit në kuadër të Qeverisë së Kosovës, nuk kemi emetim të ri të borxhit shtetëror në tremujorin e dytë të vitit, për shkak që janë anuluar ankandet e parapara. Më poshtë janë paraqitur të dhënat për ecurinë e emetimit të letrave me vlerë gjatë periudhës janar-mars 2023.

Grafik 50. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.


Grafik 48. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.


*Vlera për shtator 2022 është anualizuar

Grafik 49. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK.

Grafik 50a. Shuma e ofruar dhe emetuar




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Emetimi i letrave me vlerë qeveritare deri në mars 2023 ishte dukshëm më i ulët se në periudhën e njëjtë të një viti më parë, përderisa kërkesa për të investuar në letra me vlerë ka vazhduar të tejkalojë ofertën e qeverisë.

Deri në mars të vitit 2023, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 51.8 milionë euro, për 13.4 përqind më pak se një vit më parë (grafik 50). Ndërsa, kërkesa për të investuar, në mungesë të alternativave investuese për diversifikim të mjeteve, vazhdimisht ka tejkalluar ofertën. Kërkesa për letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.66 herë më e lartë se sa shuma e ofruar nga Qeveria, ndërsa në vitin paraprak ishte për 1.37 herë më e lartë (grafik 50a). Investuesit kryesor në borxhin e qeverisë të Kosovës në formë të letrave me vlerë janë fondet pensionale, që këtë vit kanë rritur pjesëmarrjen në gjithsej borxhin e qeverisë në 64.1 përqind nga 62.5 përqind në mars të vitit 2022, ndërsa bankat komerciale kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 30.4 përqind nga 32.7 përqind në vitin e kaluar. Deri në mars 2023, stoku i letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës të mbajtur nga bankat, pensionet dhe sigurimet arriti vlerën në 859.2 milionë euro (873.3 milionë euro në mars të vitit të kaluar). Struktura e letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës ndër vite ka pësuar ndryshime graduale drejt emetimit të letrave me vlerë me afat më të gjatë maturimit. Në periudhën janar-mars 2023, struktura u dominua me 48.3 përqind nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitet prej '5 viteve', për dallim nga viti paraprak ku emetimi i fletë-obligacioneve me maturitet prej '3 viteve' kishte pjesëmarrje prej 41.8 përqind (grafik 51).

Grafik 51. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 43, TM2 2023, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org/)

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu)

IMF (FMN): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

World Bank: Commodity Markets: [Commodity Markets \(worldbank.org\)](http://worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web:www.bqk-kos.org